




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY



REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVES	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 03-03/DPK	Nr. Prot. 01-622/16
Dep. 03	Prot. No. 16-02-2016
Nr. i tag. 03	Date 16-02-2016
Nr. pages 03	Date 16-02-2016

DATE/A:	16.02.2016
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP 03-03/527/16
PËR/ZA/TO:	z. Salih KQIKU Drejtor i Departamentit të Prokurimit në Komunën e Gjilanit
CC:	z. Lutfi HAZIRI Kryetar i Komunës së Gjilanit
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Furnizim me IPAD-a për nevoja të këshilltarëve komunal "

I nderuari z. Kqiku ,

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nënpar. 1.1. dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nënpar. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nënpar. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " Furnizim me IPAD-a për nevoja të këshilltarëve komunal " me numër prokurimi Gi651-16-008-121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Furnizim me IPAD-a për nevoja të këshilltarëve komunal " me numër prokurimi Gi651-16-008-121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit Nr.04/L-042, për Prokurimin Publik dhe të akteve tjera nënligjore që derivojnë nga ky ligj.

Arsy etimi

Komuna e Gjilanit si Autoritet kontraktues ka përgatitur njoftimin për kontratë me titull " Furnizim me IPAD-a për nevoja të këshilltarëve komunal " me numër prokurimi Gi651-16-008-121, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me datë 03.02.2014. Agjencia kundër korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka kërkuar dokumentacionin përkatës para hapjes së tenderit dhe pasi ka trajtuar të njëjtin ka konstatuar faktet si në vijim:

Në njoftimin për kontratë i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, Autoriteti kontraktues ka kërkuar që të furnizohet me 50 IPAD-a për nevoja të këshilltarëve komunal të Kuvendit Komunal të Gjilanit të llojit ***IPAD të modelit MAC IPAD AIR 16 GB Gold Sprint të prodhuesit Apple me seli në Kaliforni të Shteteve të Bashkuara të Amerikës***. Agjencia pasi ka analizuar kërkesën e njësisë kërkuuese dhe dosjen e këtij tenderi, konstaton se Autoriteti kontraktues ka përcaktuar prodhuesin dhe origjinën e këtyre pajisjeve duke mos shtuar edhe fjalët ***“ ekuivalente ose e barasvlershme”***

Me përcaktimin e emrit të prodhuesit dhe origjinës të këtyre mallrave, mund të favorizohen prodhuesit e caktuar dhe në të njëjtën kohë diskriminohen prodhuesit tjetër të këtyre pajisjeve. Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që produkti të jetë i kualitetit të lartë dhe mund t'i referohet një standardi vendor, Europian ose ndërkombëtar, por nuk lejohet assesit të kërkojë që origjina e këtyre pajisjeve të jetë nga ndonjë vend i caktuar si dhe nuk është e lejuar që pajisjet të kërkojnë nga ndonjë prodhues i caktuar.

Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, është si rregull i përgjithshëm ***i ndaluar***. Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdoret në raste të veçanta, nëse referenca e tillë përcjellët me fjalët ***“ose e barasvlershme”***.

Njësia kërkuuese pranë Autoritetit kontraktues duhet të ketë kujdes që me rastin e formulimit të specifikimeve teknike të mos formulojë specifikime favorizuese për prodhues të caktuar e në të njëjtën kohë t'i diskriminojë Operatorët tjerë ekonomik. Autoriteti kontraktues duhet t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Agjencia gjithashtu vëren se në kërkesën e njësisë kërkuuese që në këtë rast është Kuvendi i Komunës, kërkesa është për furnizim me **50 IPAD** për anëtarët e kuvendit, lidhur me këtë AKK vëren se Kuvendi ka gjithsej **35 anëtarë të kuvendit**. Në dokumentacion që posedon Agjencia, Autoriteti kontraktues nuk ka dhënë sqarime më të detajuara se për kë është dedikuar sasia tjetër prej 15 copë e këtyre pajisjeve. Shqetësuese mbetet për AKK-në, kërkesa e Autoritetit kontraktues që të furnizohet me pajisje të tilla nga prodhuesi *Apple* kur kihet parasysh fakti se në treg produktet

e këtij prodhuesi janë nga më të shtrenjtat dhe konsiderohen si luksoze.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi, nenin 28 Specifikimet teknike të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 dhe nenin 18 pika 7 të udhëzuesit operativ të prokurimit publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet të lejohen në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

